Udhëzimet për plotësimin e "Formularit për Raportim Vjetor Financiar":

"*Emri i Organizatës Buxhetore*": Ju lutem plotësoni emrin zyrtar të organizatës suaj.

"*Kodi i Organizatës Buxhetore*": Ju lutem plotësoni kodin zyrtar të organizatës suaj sipas tabelës së llogarive për vitin 2019.

"*Informatat Kontaktuese*": Ju lutem paraqitni emrin e personave kontaktues të organizatës tuaj si Zyrtari Kryesorë Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, (numri i telefonit dhe e-mail adresa)

"Data": Ju lutem plotësoni datën e dorëzimit të raportit financiar në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

1) "*Hyrje*": Ju lutem paraqitni një përmbledhje të shkurtër për zhvillimet kryesore në buxhetin e organizatës suaj në vitin 2019. Ju lutem ta bëni këtë shkurtimisht dhe të fokusoheni në aspektet kryesore të buxhetit tuaj – hapësira është e kufizuar!

2) "Përmbledhje për të hyrat dhe kategoritë e veçanta të shpenzimeve": Ju lutem paraqitni një vlerësim të zhvillimeve në të hyrat dhe kategoritë individuale të shpenzimeve. Fokusi duhet të jetë në vlerësimin e organizatës suaj për sa i përket kategorive individuale në kuadër të buxhetit të organizatës suaj. A kanë qenë të mjaftueshme fondet në dispozicion? Cilat kanë qenë përparësitë dhe dobësitë në përmbushjen e qëllimeve të parapara për sa i përket të hyrave dhe shpenzimeve? Cilat janë arsyet që kanë shkaktuar këto zhvillime?

2a) "*Të hyrat*": Ju lutem, paraqitni një përmbledhje të zhvillimeve në të hyrat e organizatës suaj duke u fokusuar posaçërisht në të hyrat aktuale krahasuar me të hyrat e planifikuara. Nëse organizata juaj nuk gjeneron të hyra, ju lutem ta cekni këtë fakt shkurtimisht.

2b) "*Pagat dhe mëditjet*": Ju lutem paraqitni informata lidhur me zhvillimet e pagave dhe mëditjeve ne organizatën tuaj. Theks i veçantë duhet t'i kushtohet mjaftueshmërisë së fondeve për numrin e pozitave të plotësuara, krahasimit të pagave dhe mëditjeve në organizatën tuaj me pagat dhe mëditjet e shërbyesve civil dhe numri i pozitave të plotësuara krahasuar me numrin e pozitave të aprovuara dhe arsyet për devijimet e mundshme. Ju lutem, në mënyrë që raporti të cilësohet si i kompletuar, Komisioni për Buxhet dhe Financa kërkon dorëzimin e organogramit të organizatës tuaj si dhe plotësimin e informative të kërkuara në tabelën 4g).

2c) "*Mallrat dhe Shërbimet*": Ju lutem paraqitni një përmbledhje për zhvillimet në shpenzimet që organizata juaj ka bërë për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve krahasuar me shpenzimet e planifikuara dhe ndonjë zhvillim të posaçëm në këtë drejtim, p.sh. blerjet e mëdha dhe proceset e prokurimit.

2d) "Shpenzimet Komunale": Ju lutem paraqitni një përmbledhje për zhvillimet në shpenzimet që organizata juaj ka bërë në kategorinë e shpenzimeve komunale krahasuar me shpenzimet e parapara.

2e) "*Investimet kapitale*": Ju lutem paraqitni një përmbledhje për zhvillimet në shpenzimet që organizata juaj ka bërë në kategorinë e shpenzimeve kapitale

krahasuar me shpenzimet e planifikuara. Nëse organizata juaj nuk ka shpenzime në këtë kategori, ju lutem ta cekni këtë fakt shkurtimisht.

2f) "Transferet dhe subvencionet": Ju lutem paraqitni një përmbledhje të zhvillimeve të shpenzimeve të organizatës suaj për transfere dhe subvencione, duke u fokusuar posaçërisht në shpenzimet aktuale krahasuar me shpenzimet e planifikuara. Po ashtu paraqitni një përmbledhje të shkurtër për përfituesit e këtyre transfereve dhe subvencioneve. Nëse organizata juaj nuk ka shpenzime në kategorinë e transfereve dhe subvencioneve, ju lutem ta cekni këtë fakt shkurtimisht.

3) "*Përmbledhje*": Në këtë seksion mund të paraqitni një përmbledhje të ekzekutimit të buxhetit të organizatës suaj apo të paraqitni shkurtimisht opinionin tuaj lidhur me zhvillimet e buxhetit të organizatës suaj në të ardhmen.

4) "*Tabelat*": Ju lutem lexoni udhëzimet për plotësimin e tabelave me kujdes. Në tabelat 4a) dhe 4b) mund të shtoni rreshta për informata shtesë. Nuk lejohet të shtoni kolona shtesë në tabelë. Ju lutem paraqitni të dhënat për secilën linjë buxhetore dhe jo të dhëna të përgjithësuara, p.sh. të paraqiten të dhënat bazuar në kodet ekonomike, p.sh. qira, shpenzime të udhëtimit, karburant për vetura, karburant për gjeneratorë, etj. Tabela 4c) nuk mund të ndryshohet, prandaj ju lutem plotësoni të dhënat e kërkuara. Ju lutem paraqitni të gjitha të dhënat e kërkuara. Në të kundërtën, raporti nuk do të cilësohet si i kompletuar!

4.a) "Të hyrat": Ju lutem paraqitni të dhënat e kërkuara për të gjitha llojet e të hyrave të organizatës suaj sipas detajeve të specifikuara më poshtë:

(1) "Kodi ekonomik" për linjën buxhetore përkatëse mund të gjindet në tabelën e llogarive për vitin 2019.

(2) Emri i kategorisë ekonomike për linjën buxhetore përkatëse po ashtu mund të gjindet në tabelën e llogarive për vitin 2019.

(3) Paraqitni shumën për "*Të hyrat e planifikuara/projektuara për vitin 2019*" siç është specifikuar në Buxhetin e vitit 2019.

(4) Paraqitni të dhënat për "*Të hyrat vetanake të bartura nga viti 2018*" sipas përcaktimit me Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018.

(5) Paraqitni të dhënat për "*Të hyrat aktuale për vitin 2019*", d.m.th. të hyrat që organizata juaj i ka gjeneruar në vitin 2019.

4.b) "*Shpenzimet*": Ju lutem paraqitni të dhënat e kërkuara për të gjitha llojet e shpenzimeve të organizatës suaj sipas detajeve të specifikuara më poshtë:

(1) "Kodi ekonomik" për linjën buxhetore përkatëse mund të gjindet në tabelën e llogarive për vitin 2018 dhe 2019.

(2) Emri i kategorisë ekonomike për linjën buxhetore përkatëse po ashtu mund të gjindet në tabelën e llogarive për vitin 2018 dhe 2019.

(3) Paraqitni shumën për "*Shpenzimet për vitin 2018*" për këtë linjë buxhetore.

(4) Paraqitni shumën për "*Buxhetin Vjetor 2019*", d.m.th. buxhetin e aprovuar sipas Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019 në këtë linjë buxhetore.

(5) Paraqitni shumën e "buxhetit me ndryshim nëse ka pasur me rishikim 2019"

(6) Paraqitni buxhetin përfundimtar për vitin 2019 (përfshirë ndryshime nëse ka pasur ne organizatën e juaj në bazë të LIGJIT PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2019).

(7) Paraqitni shumën për "shpenzimet aktuale deri me *31.12.2019*", d.m.th. fondet aktuale të shpenzuara nga organizata në linjën e caktuar buxhetore deri më 31 dhjetor 2019.

(8) Paraqitni shumën për "*Zotimet deri më 31.12.2019*", d.m.th. fondet që janë zotuar nga organizata juaj për linjën e caktuar buxhetore deri më 31 dhjetor 2019.

(9) Paraqitni shumën për "Buxhetin e zotuar (ne %)" nga buxheti i përgjithshëm i flokuar.

(10) Paraqitni shumen aktuale për buxhetin e shpenzuar (në %) nga buxheti i përgjithshëm në fund të vitit, për këtë linje buxhetore.

4.c) Paraqitni të dhënat në bazë të tabelave për Mallra dhe Shërbime për vitin 2018 dhe për vitin 2019.

4.d) Paraqitni të dhënat në bazë të tabelave për Shpenzime Komunale për vitin 2018 dhe për vitin 2019.

4.e) Paraqitni të dhënat në bazë të tabelave për Investime Kapitale për vitin 2018 dhe për vitin 2019.

4.f) Paraqitni të dhënat në bazë të tabelave për Subvencione dhe Transfere për vitin 2018 dhe për vitin 2019, (nëse keni pasur mjete në këtë kategori në organizatën e juaj).

4.g) "Struktura e personelit dhe pagesat":

(1) "Niveli" paraqet nivelin e punësimit për të cilin në kolonat në vijim duhet të paraqiten informata; nuk është e domosdoshme te plotësohen te dhëna në këtë kolonë.

(2) Paraqitni numrin e "pozitave të aprovuara në buxhet" për vitin 2019 për organizatën tuaj, d.m.th. numri i pozitave sipas specifikimit ne Ligjin për Buxhetin e Republikës se Kosovës për vitin 2019.

(3) Paraqitni numrin e "pozitave të plotësuara" aktualisht për Organizatën tuaj.

(4) Paraqitni shumën e "Totalit të aprovuar ne buxhet për Pagat" për vitin 2019 për organizatën tuaj, d.m.th. fondi total për paga për organizatën tuaj, që janë aprovuar me Ligjin për Buxhetin e Republikës se Kosovës për vitin 2019.

(5) Paraqitni shumën e "Totalit te shpenzuar për paga" për vitin 2019 nga organizata juaj, d.m.th. fondet e përgjithshme aktuale të shpenzuara për paga nga organizata juaj në vitin 2019.

(6) Paraqitni shumën e "Totalit të pagesave shtesë" që janë shpenzuar nga organizata juaj, d.m.th. shuma e të gjitha pagesave (shtesë) të organizatës suaj që janë pranuar në vitin 2019 si shtesë në pagat e rregullta.

(7) Paraqitni shumën për "Numrin e përgjithshëm të pranuesve të pagesave shtesë" për vitin 2019, d.m.th. numri i punëtorëve ne organizatën tuaj që kanë pranuar pagesa shtesë.

(8) Ju lutem, paraqitni informata për "*a) Orari i punës (orar i plotë/gjysmë orari)*", d.m.th. saktësoni që të punësuarit në këtë nivel punojnë me orar të plotë apo gjysme orari. *b) specifikoni llojin e pagesës shtesë*", d.m.th. listoni pagesat shtesë që të punësuarit në organizatën tuaj kanë pranuar në nivelin e caktuar, duke i cekur emrat e pagesave dhe duke dhënë një shpjegim te shkurtër për arsyetimin për pagesën shtesë për vitin 2019.

Ju lutem bashkangjitni Organogramin (strukturën organizative) të organizatës tuaj.